



Dhuna në familje -

Dhuna në lidhje

Informacione • Ndihmë • Adresa



## Parathënie

Më 1 shkurt 2018, në Gjermani hyri në fuqi Konventa e Stambollit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave. Kështu, Gjermania është angazhuar për masa gjithëpërfshirëse për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, për të mbrojtur viktimat dhe për të ndëshkuar autorët.

Çdo vit, në policinë e qarkut Steinfurt raportohen një numër i madh i rasteve të dhunës në familje. Në qarkun e Steinfurt, Runde Tisch (Tryeza e rumbullakët) për Dhunën në Familje u themelua nën patronazhin e Administratorit të Qarkut më 8 korrik 2003.

Objektivat e Runde Tisch janë:

- Parandalimi i dhunës në familje
- Përmirësim i dukshëm në mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave
- Ulja e incidencës së dhunës në familje përmes parandalimit

Kjo broshurë merr parasysh faktin që gratë preken nga dhuna në familje më shpesh se mesatarja. Prandaj, gratë trajtohen kryesisht si personat e prekur.

Sigurisht që deklaratat vlejné edhe për të gjithë personat e tjerë që kërcënohen apo preken nga dhuna në familje.

## Redaktor:

„Runder Tisch – Dhuna në familje, qarku Steinfurt“

Person kontakti: Oficerja e qarkut për shanse të barabarta Brigitte Kumpmann,

Persona të mëtejshëm kontakti mund të gjenden në faqen kryesore:

[www.kreis-steinfurt.de/häuslichegewalt](http://www.kreis-steinfurt.de/häuslichegewalt)

Botuar: Dhjetor 2022



financuar nga:

Ministerium für Kinder, Jugend, Familie,  
Gleichstellung, Flucht und Integration  
des Landes Nordrhein-Westfalen



Nën patronazhin e Administratorit të Landit të qarkut të Steinfurt

 KREIS  
STEINFURT

## Tabela e përmbajtjes

Drejtuar grave . . . . .	4
Çfarë është “dhuna në familje”? . . . . .	5
Cilat janë format e dhunës në familje që ekzistojnë? . . . . .	6
Dhuna akute në familje - çfarë të bëni? . . . . .	7
Dëbimi nga shtëpia . . . . .	8
Ndalimi i kthimit . . . . .	8
Verifikim nëse ndalimi i kthimit është respektuar . . . . .	9
Masa të tjera të mundshme sigurie nga policia . . . . .	9
Si mund të vazhdojë? . . . . .	10
Çfarë mundësish ekzistojnë për mbrojtje ligjore? . . . . .	11
Urdhrat e mbrojtjes nga gjykata . . . . .	11
Ndarja e banesës së përbashkët . . . . .	12
Kohëzgjatja e caktimit të strehimit . . . . .	12
Dëmshpërblim dhe kompensim për dhimbjen dhe vuajtjet . . . . .	13
Kujdestaria, e drejta e qëndrimit, e drejta e aksesit . . . . .	13
Zhvendosja nga banesa - ku? . . . . .	14
Çfarë ndihme është në dispozicion për gratë? . . . . .	15
Telefoni i ndihmës . . . . .	15
Qendrat e këshillimit të grave . . . . .	16
Oferta të tjera mbështetëse . . . . .	17
Çfarë ndihme është në dispozicion për fëmijët? . . . . .	18
Çfarë ndihme është në dispozicion për djemtë dhe burrat? . . . . .	19
Siguria ka prioritet - çfarë të bëni? . . . . .	20
Zhvendosja nga banesa - çfarë nevojitet? . . . . .	21
Çfarë ndihme financiare ekziston? . . . . .	22
Përfitimet sipas SGB II (Kodi Gjerman i Sigurimeve Shoqërore) . . . . .	22
Përfitimet sipas UVG (Ligji i avancuar i mirëmbajtjes) . . . . .	22
Shërbimet sipas OEG (Ligjit për Kompensimin e Viktimave nga Aktet e Dhunshme) . . . . .	23
Adresa dhe numra telefoni . . . . .	24-27

## Drejtuar grave

Të dashura gra,

Në gjermani ju mund të jetoni të lira. Si gra, ju keni të njëjtat të drejta si burrat. Mendimi juaj vlen po aq sa mendimi i një burri dhe mendimi i familjes suaj. Ju mund të vendosni vetë se si dëshironi të jetoni. Ju (dhe fëmijët tuaj) keni të drejtën për një jetë pa dhunë.

### Çfarë do të thotë kjo?

Ju mund të vendosni gjithçka vetë. Ju nuk keni pse të kërkonti leje nga askush. Për shembull, ju mund të vendosni:

- Ku dhe si dëshironi të jetoni. Për shembull, ju mund të jetoni vetëm ose së bashku me gra ose burra. Nuk është e nevojshme të jesh i martuar nëse dëshiron të jetosh me dikë tjetër.
- Nëse dëshironi të jeni në një lidhje, të martoheni, të ndaheni ose të divorcoheni. Ju mund të vendosni se me kë do të martoheni. Mund të martoheni edhe me një grua tjetër.
- Nëse dëshironi të puthni një person tjetër ose të bëni seks me të. Ju gjithashtu vendosni vetë nëse dëshironi ta përsërisni këtë. Kjo vlen edhe nëse jeni e martuar.
- Nëse dëshironi të keni fëmijë dhe sa fëmijë dëshironi të keni. Kjo gjithashtu përfshin nëse dhe si dëshironi të përdorni kontracepsionin dhe nëse dëshironi të bëni një abort të një shtatzënie.
- Kur doni të dilni nga shtëpia/apartamenti, ku doni të shkoni dhe kë dëshironi të takoni.
- Nëse dëshironi të hapni llogarinë tuaj në një bankë, çfarë doni të bëni me paratë, sa para shpenzoni dhe për çfarë.
- Cilin profesion do të dëshironit të mësoni dhe cilën punë do të pranoni. Kjo përfshin gjithashtu nëse dëshironi të mësoni një zanat apo nëse dëshironi të studioni.
- Nëse dëshironi të jeni politikisht aktive, për cilën parti dhe cilët njerëz dëshironi të votoni.
- Se si i rrisni fëmijët tuaj. Por: Ju jeni të detyruar t'i mbronni fëmijët tuaj nga dhuna! Fëmijët NUK duhet të goditen, shkelmohen apo lëndohen në asnjë mënyrë tjetër në Gjermani! Kjo është kundër ligjit!

## Çfarë është “dhuna në familje”?

### Dhuna në familje

Dhuna në familje përfshin dhunën që ndodh ndërmjet njerëzve që janë ose kanë qenë në një marrëdhënie të ngushtë shoqërore me njëri-tjetrin, p.sh. midis

burrave dhe grave,

prindërve dhe fëmijëve si dhe

partnerëve që i përkasin të njëjtës gjini.

Dhuna në familje

- zakonisht zhvillohet në atë që supozohet të jetë një strehë shtëpiake
- është një proces gradual në të cilin poshtërimi dhe aktet e dhunës dhe pasojat shoqërore për të prekurit janë në rritje të vazhdueshme
- është një cikël në të cilin fazat e përdorimit të dhunës alternohen me fazat e shprehjes së pendimit dhe premtimeve për përmirësim nga dhunuesi
- prek kryesisht gratë dhe fëmijët
- në shumicën e rasteve vjen nga meshkujt, edhe në rastet që preken meshkujt
- nuk është një çështje private, por një çështje publike!

## Cilat janë format e dhunës në familje që ekzistojnë?

Si rregull, format e ndryshme nuk ushtrohen individualisht, por janë më tepër të kombinuara me njëra-tjetrën. Në thelbin e saj, shpesh ka të bëjë me ushtrimin e pushtetit dhe kontrollit. Format e dhunës përfshijnë p.sh.:

### **Dhuna fizike:**

Kjo përfshin shtyrjen, përplasje, goditje, boks, shkelmim, mbytje, shtrëngim, lidhje, djegie, hedhjen e gjërave, tërheqjen e flokëve, privimin nga ushqimi, sulmet me armë etj. deri në tentativë për atentat dhe vrasje.

### **Dhuna seksuale:**

Të gjitha aktet seksuale që kryhen me detyrim ose i imponohen një personi duhet të konsiderohen si dhunë seksuale. Kjo përfshin akte të tilla si detyrimi i të tjerëve për t'u përfshirë në aktivitet seksual, ngacmimi seksual, përdhunimi, kërcënimet seksuale, sulmet seksuale, trajtimi i të tjerëve si objekte seksuale, abuzimi seksual, shfrytëzimi seksual, etj.

### **Dhuna psikologjike / emocionale**

Ajo përfshin akte të tilla si intimidimi, fyerja, kërcënimi, frikësimi, bërtitjet e përsëritura, heshtja sistematike, poshtërimi dhe degradimi para të tjerëve, shkatërrimi i sendeve me vlerë të lartë personale, bërra përgjegjës e viktimës për dhunën dhe fajësimi, kërcënimi për marrjen e fëmijëve etj.

### **Dhuna ekonomike:**

Ajo përfshin ndalimin ose detyrimin për të punuar, ndarjen e parave, mohimin ose marrjen e parave, kontrollin e shpenzimeve, mohimin e hyrjes në llogari etj.

### **Dhuna sociale:**

lidhet me jetën shoqërore dhe përfshin akte të tilla si abuzimi me privilegjin, trajtimi i personit tjetër si shërbëtor, marrja e vendimeve pa prezencën ose për personin në fjalë, kufizimi, monitorimi dhe kontrolli i kontakteve, ndalimi për të ndjekur një kurs gjuhësor, daljet jashtë ose takimet me miqtë ose familjarët, të quajturit të çmendur, burgosja etj.

## Dhuna akute në familje - çfarë të bëni?

### **Përndjekja:**

Përndjekja ndodh shpesh pas një ndarjeje ose në rastet kur personi tjetër nuk e pranon. Ajo përfshin telefonata të vazhdueshme, mesazhe SMS, mesazhe me zë në aparatit telefonik ose e-mail në çdo kohë të ditës dhe natës, letra dashurie / lule / dhurata, porosi për mallra në emër të personit të prekur, ndjekje dhe pritë, akuzat të rreme ( p.sh. tek punëdhënësi), marrja në pyetje e rrethit të personave të njohur, dëmtimi i pronës, fyerje, kërcënime, shtrëngime etj. Përndjekja mund të bëhet edhe në formë dixhitale si përndjekje kibernetike (shih gjithashtu dhunën dixhitale).

### **Dhuna dixhitale:**

Dhuna dixhitale do të thotë që njerëzit nënçmohen, ofendohen, ngacmohen, diskriminohen ose u bëhet presion për diçka me ndihmën e pajisjeve dhe mediave dixhitale ose në hapësirën dixhitale (dhoma chat-i, faqe interneti, nëpërmjet Instantmessaging, në portalet e internetit si Facebook, Instagram, etj.).

Nëse jeni keqtrajtuar, kërcënuar ose fyer, mbrojeni veten!

Mos prisni derisa të pësoni poshtërim dhe lëndim!

Përvoja ka treguar se dhuna në marrëdhënie rritet herë pas here.

## **Ju nuk duhet ta pranoni dhunën!**

## **Ju nuk jeni pa mbrojtje dhe pa të drejta në këtë situatë!**

Në një situatë akute të rrezikshme telefononi menjëherë

### **POLICINË NË NUMRIN E URGJENCËS 110!**

Policia është aty për t'ju mbrojtur dhe ka mundësi të ndryshme për të ndërmarrë veprime kundër autorit. Në Nordrhein-Westfalen, për shembull, policia mund të marrë masa kundër dhunuesit në përputhje me nenin § 34a të Aktit të Policisë së NRW. Kjo përfshin dëbimin nga shtëpia dhe ndalimin që autori të kthehet. Këto masa ndjekin moton:

**„AUTORI LARGOHET – VIKTIMA QËNDRON!“**

## Dëbimi nga shtëpia

Për të shmangur një rrezik aktual, që buron nga autori, për gjymtyrët, jetën ose lirinë e një personi tjetër, autori në parim mund të dëbohet nga shtëpia ku jeton personi i rrezikuar dhe nga ambientet në afërsi të tyre.

Kjo zakonisht është e nevojshme për të thyer ciklin e dhunës.

## Ndalimi i kthimit

Autorit mund t'i ndalohet kthimi në banesë dhe në zonën në afërsi të shtëpisë për një periudhë dhjetë ditore.

Nëse autori është ende në shtëpi kur mbërrin policia, është gjithmonë ai që dëbohet nga shtëpia dhe i ndalohet që të kthehet në shtëpi.

Nëse autori nuk ndodhet në shtëpi në momentin e lëshimit të urdhrit, atij do t'i shqiptohet vetëm ndalimi i kthimit.

Policia i jep mundësinë autorit të marrë menjëherë me vete çdo send personal që i nevojitet në mënyrë imediate.

Nëse autori ka nevojë për sende të tjera personale gjatë periudhës së ndalimit të kthimit, mund t'i marrë ato vetëm nëse shoqërohet nga policia.

Në çdo rast do të njoftoheni paraprakisht nga policia; data dhe orari do të dakordësohen me ju.



## Verifikim nëse ndalimi i kthimit është respektuar

Për mbrojtjen tuaj, policia do të kontrollojë respektimin e ndalimit të kthimit të paktën një herë gjatë këtyre dhjetë ditëve.

Gjatë këtyre dhjetë ditëve ju mund të qëndroni në banesën tuaj të pashqetësuar dhe nuk duhet ta lejoni autorin të kthehet në banesën tuaj!

## Masa të tjera të mundshme sigurie nga policia

Nëse kërkesat ligjore të nenit § 34a të Ligjit të Policisë së NRW nuk përmbushen, policia mund të marrë masa të tjera të përkohshme kundër shkelësve.

Këto masa mund të jenë p.sh.:

- Ndalim i hyrjes në një zonë
- Paraburgim
- Sigurimi i çelësit të banesës

Policia do të raportojë çdo rast të dhunës në familje që i bie në sy.

Si viktimë ju do të merrni dokumentacionin nga policia për përdorimin e dhunës në familje, të cilin ndër të tjera mund ta përdorni si provë në proceset civile.

Gjithashtu, policia do t'ju japë broshurën "**Informacion për viktimat e dhunës në familje**" me shpjegime për veprimet e policisë dhe opsionet tuaja për mbrojtjen e ligjit civil, si dhe numrat e telefonit të qendrave të këshillimit.

## Si mund të vazhdojë?

Gjatë dhjetë ditëve të ndalimit të kthimit, ju keni mundësinë të sqaroni çështjet personale dhe familjare.

Ndër të tjera ju mund të përdorni ndihmën e qendrave të këshillimit dhe objekteve mbështetëse të listuara në faqet 24 deri në 27.

Ju keni mundësinë të aplikoni për mbrojtje sipas ligjit civil në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen Kundër Dhunës.



Nëse është e nevojshme, policia mund të zgjasë periudhën e dëbimit dhe ndalimit të kthimit derisa gjykata të vendosë për kërkesën tuaj.

Ju mund të paraqisni kërkesën tuaj në gjykatën përgjegjëse të qarkut

- ju vetë personalisht ose
- nëpërmjet një avokati/avokateje.

Nga dita e paraqitjes së kërkesës fillon një afat i ri kohor për ndalimin e autorit që të kthehet.

Afati përfundon në ditën e vendimit të gjykatës, por afati më i vonë është në ditën e dhjetë pas përfundimit të urdhrit të dëbimit të lëshuar nga policia dhe/ose ndalimit të kthimit.



## Çfarë mundësish ekzistojnë për mbrojtje ligjore?

Më poshtë janë opsionet e mundshme për mbrojtje sipas ligjit civil:

- rregulloret e përgjithshme për mbrojtjen e personalitetit
- ndarja e banesës së përbashkët
- e drejta e qëndrimit ose kujdestaria e fëmijëve
- pezullimi ose kufizimi i qasjes tek fëmijët
- Dëmtshpërblim dhe kompensim për dhimbjen dhe vuajtjet

Urdhrat e përgjithshëm të mbrojtjes dhe ndarja e banesës së përbashkët shërbejnë si mbrojtje parandaluese ndaj akteve të mëtejshme të dhunës.

Kur aplikoni, duhet ta bëni të besueshme ekzistencën e dhunës në familje.

Ju mund ta bëni këtë, për shembull, duke përdorur "Dokumentacionin për ndërhyrjen e policisë në rastet e dhunës në familje" që ju është dhënë nga policia.

## Urdhrat e mbrojtjes nga gjykata

Sipas nenit § 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna, gjykata e qarkut mund të lëshojë urdhra mbrojtës për të parandaluar lëndime të mëtejshme nëse jeni lënduar qëllimisht nga dhunuesi për sa i përket trupit, shëndetit ose lirisë.

Gjykata mund ta ndalojë autorin që

- të hyjë në banesën tuaj,
- t'i afroheni banesës tuaj brenda një rrezeje që do të përcaktohet,
- të vizitohet vende të tjera ku ju shkon rregullisht (p.sh. në vendin tuaj të punës ose në kopshtin e fëmijëve),
- t'ju kontaktojë ju (personalisht, me telefon, faks, letër ose e-mail) ose
- të bëjë takim „të rastësishme“ me ju.

Në varësi të rrethanave të rastit individual, gjykata mund të urdhërojë edhe masa të tjera nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen tuaj.

Urdhrat e mbrojtjes lëshohen për një periudhë të kufizuar kohore.

Shkelja nga autori i urdhrave të mbrojtjes së gjykatës dënohet sipas nenit § 4 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna.

## Ndarja e banesës së përbashkët

Nëse jeni viktimë e lëndimit fizik, lëndimit të shëndetit ose lirisë suaj dhe jetoni me dhunuesin në një familje të përbashkët afatgjatë, mund të aplikoni në gjykatën përgjegjëse të qarkut për lirim dhe banesës së përbashkët në përputhje me nenin § 2 të Ligjit për Mbrojtjen Kundër Dhunës.

Edhe nëse autori ju ka kërcënuar me lëndime të tilla, ju keni të drejtë t'ju jepet shtëpia e përbashkët, nëse kjo është e nevojshme, për të shmangur "vështirësi të paarsyeshme". Kjo ndodh, për shembull, në rastin kur mirëqenia e fëmijëve tuaj rrezikohet seriozisht.

Kusht paraprak për të drejtën e dhënies së banesës është që ju ose avokati juaj t'i keni kërkuar me shkrim autorit që t'i jepet apartamenti brenda tre muajve nga vepra ose nga kërcënimet.

## Kohëzgjatja e caktimit të strehimit

Nëse autori është qiramarrësi ose pronari i vetëm i banesës, kohëzgjatja e caktimit të strehimit fillimisht do të kufizohet për aq kohë sa është e nevojshme për mbrojtjen tuaj.

Kohëzgjatja maksimale është zakonisht gjashtë muaj, por ky afat mund të zgjatet.

Nëse keni një marrëveshje qiraje të përbashkët për banesën me autorin, ose nëse banesa është pronë e juaj e përbashkët, gjykata do ta bazojë afatin kohor për ndarjen e banesës në rrethanat e rastit individual.

Autori nuk duhet të pengojë ose vështirësojë përdorimin ekskluziv të banesës nga ana juaj. Gjykata mund ta ndalojë shprehimisht edhe ndërprerjen e kontratës ose shitjen e banesës.

## Dëmshpërblim dhe kompensim për dhimbjen dhe vuajtjet

Sipas nenit § 823 të Kodit Civil Gjerman, ju mund të ngrini pretendime për dëmshpërblim kundër autorit të veprës nëse autori me dashje ose nga pakujdesia ka dhunuar jetën tuaj, trupin tuaj, shëndetin tuaj, lirinë tuaj, pronën tuaj ose ndonjë të drejtë tjetër.

Përveç kësaj, ju keni të drejtën e kompensimit për dhimbjen dhe vuajtjen në rast të dëmtimit të trupit, shëndetit, lirisë ose vetëvendosjes seksuale në përputhje me nenin § 253 paragrafi 2 të Kodit Civil Gjerman.

Ju mund t'i parashtroni këto pretendime në gjykatë përmes një avokati apo avokate.

## Kujdestaria, e drejta e qëndrimit, e drejta e aksesit

Fëmijët që jetojnë në familje shpesh preken nga dhuna në familje.

Megjithatë, dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna nuk zbatohen për fëmijët. Në vend të këtij ligji, zbatohen normat mbrojtëse të ligjit për fëmijët.

Për të kursyer fëmijët tuaj nga përvojat e mëtejshme të dhunës, ju mund të aplikoni në gjykatën e qarkut për transferimin e kujdestarisë së vetme ose të paktën për të pasur të drejtën për të përcaktuar vendbanimin tuaj.

Në këtë rast këshillohet që të kërkoni ndihmën e një avokati dhe/ose ndihmën e zyrës së mirëqenies së të rinjve që është përgjegjëse për ju. Nëse keni të ardhura të ulëta, mund të aplikoni për ndihmë juridike në gjykatën përgjegjëse të qarkut.

Edhe nëse ju është dhënë kujdestaria e vetme, gjithsesi babai i fëmijës ka gjithashtu të drejtën themelore për të kontaktuar me fëmijët.

Nëse nuk mund të arrihet një zgjidhje miqësore midis jush dhe babait të fëmijës, gjykata e qarkut do të vendosë për shtrirjen dhe ushtrimin e të drejtës së aksesit.

## Zhvendosja nga banesa - ku?

Nëse ju, si shumë viktime të tjera të dhunës në familje, nuk dëshironi të qëndroni në apartamentin që keni ndarë më parë dhe nuk mund të qëndroni me të afërmit ose të njohurit, ju keni mundësinë të kërkonti ndihmën e një strehimoreje për gratë.

Në qarkun e Steinfurt mund të kontaktoni strehën e grave në Rheine.  
Adresa është sekrete për mbrojtjen e banoreve.

**Strehimi i grave në Rheine, telefon: 0 59 71 / 1 27 93**  
**Telefoni funksionon 24 orë në ditë.**

Pyetjet e rëndësishme mund të sqarohen gjatë bisedës tuaj telefonike, p.sh. se cilat dokumente ju duhet të merrni me vete kur të pranoheni në strehimore.

Streha e grave nuk është shtëpi. Gratë që jetojnë atje përcaktojnë vetë jetën e tyre dhe jetën e tyre të përditshme.

Aty ju dhe fëmijët tuaj do të gjeni:

- strehim dhe mbrojtje,
- konsulencë falas si dhe
- ndihmë dhe mbështetje.

Në konsultën eksperte dhe individuale, ndër të tjera do të informoheni edhe për çështjet ligjore të listuara më sipër.

Ndihma dhe mbështetja synojnë t'ju bëjnë më të lehtë planifikimin e jetës suaj të ardhshme, p.sh. kur të kërkonti një apartament të ri, një kopsht tjetër ose një shkollë tjetër për fëmijët tuaj.

Në faqet e mëposhtme të internetit do të gjeni lehtësira të mëtejshme ndihme dhe mbështetjeje dhe vende falas në strehimoret e grave:

[www.frauen-info-netz.de/](http://www.frauen-info-netz.de/)

[www.frauenhauskoordinierung.de/hilfe-bei-gewalt](http://www.frauenhauskoordinierung.de/hilfe-bei-gewalt)

[www.odabs.org/nordrhein-westfalen/liste.html](http://www.odabs.org/nordrhein-westfalen/liste.html)

[www.bmfsfj.de/bmfsfj/themen/gleichstellung/frauen-vor-gewalt-schuetzen](http://www.bmfsfj.de/bmfsfj/themen/gleichstellung/frauen-vor-gewalt-schuetzen)

## Çfarë ndihme është në dispozicion për gratë?

### TELEFONI I NDIHMËS DHUNA KUNDËR GRAVE

Linja telefonike e ndihmës „Dhuna kundër grave“ jep këshilla për numrin

**08000 116 016** dhe online në faqen e internetit **www.hilfetelefon.de**

për të gjitha format e dhunës, 24 orë në ditë dhe pa pagesë.

Këshillimi është anonim, konfidencial, pa barriera dhe në dispozicion në 18 gjuhë, në gjuhën e shenjave dhe në gjuhë të thjeshtë.

Sipas kërkesës, këshilltarët do t'ju vënë në kontakt me një institucion lokal mbështetës.

Të njohurit, të afërmit dhe profesionistët mund të kontaktojnë gjithashtu linjën e ndihmës “Dhuna ndaj grave”.



**HILFE TELEFON  
GEWALT GEGEN FRAUEN**

**08000 116 016**

# Qendrat e këshillimit të grave

## Qendra e këshillimit të grave me qendër të integruar këshilluese të specializuar kundër dhunës seksuale të Diakonie West e.V.

### Tek ne ju merrni:

- Informacione dhe sqarime
- Këshillim
- Ndërhyrje në krizë dhe stabilizim
- Shoqërimi në gjykatë, polici, zyrën për mirëqenien e të rinjve
- Referim në grupe të tjera profesionale si p.sh. terapistë, mjekë, avokatë

Konsultimet janë vullnetare, konfidenciale, pa pagesë dhe sipas dëshirës edhe anonime. Ju dhe fëmijët tuaj keni të drejtë për një jetë pa dhunë!

### Qendrat e këshillimit të grave

-Pika kryesore e fokusit është në dhunën në familje dhe në partneritet-

Këtu mund të merrni këshilla p.sh.:

- për të gjitha format e dhunës në familje ose në partneritet
- masat e përgjithshme për mbrojtjen kundër dhunës, të tilla si aplikimet sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna, kërkimi i mbrojtjes në një strehë për gratë ose krijimi i një plani sigurie dhe emergjence
- proceset e vendimmarrjes si p.sh. shqyrtimi i ndarjes
- zhvillimi i perspektivave të reja të jetës pa dhunë
- seancat e ardhshme gjyqësore ose takimet me prindërit

Münstermauer 3  
48431 Rheine  
Tel.: 05971 800 73 70  
E-Mail: frauenberatungsstelle@diakonie-west.de  
Homepage: [www.diakonie-west.de/hilfe-beratung/hilfe-bei-gewalt-gegen-frauen](http://www.diakonie-west.de/hilfe-beratung/hilfe-bei-gewalt-gegen-frauen)

### Qendra e këshillimit kundër dhunës seksuale

-me fokus kryesor në dhunën seksuale-

Këtu mund të merrni këshilla p.sh.:

- për një përdhunim/ngacim seksual ose një tentativë për sulm
- gjithashtu për një përvojë të gjatë të dhunës seksuale
- për ngacimet seksuale në jetën e për ditshme ose në punë
- për abuzimin seksual
- për shqyrtimin e paraqitjes së një kallëzimi
- për seancat e ardhshme gjyqësore

Münsterstr. 48  
48431 Rheine  
Tel.: 05971 800 92 92  
E-Mail: [fachberatung-gewalt@diakonie-west.de](mailto:fachberatung-gewalt@diakonie-west.de)  
Homepage: [www.diakonie-west.de/hilfe-beratung/hilfe-bei-gewalt-gegen-frauen](http://www.diakonie-west.de/hilfe-beratung/hilfe-bei-gewalt-gegen-frauen)



## Oferta të tjera mbështetëse

### **Klinika e Traumës për të Rriturit**

Ndhimë për viktimat

Oferta përfshin: këshilla dhe informacione, ndihmë në trajtimin e ndjenjave të përjetuara si dërrmuese, ndihmë në rivendosjen e sigurisë dhe aftësisë për të kontrolluar etj.

Klinika ambulatore e traumës për të rritur në UKM – Spitali Universitar në Münster

Tel.: 0251/ 83-51888 ose 0251/83-57815

E-Mail: pppambulan@ukmuenster.de

web.ukm.de/index.php?id=psychosomatik\_traumaambulanz

### **Klinika ambulatore e viktimave të dhunës**

Ndihma joburokratike për personat që janë bërë viktima të dhunës:

- këshilla të kompletuara nga mjekë të trajnuar posaçërisht
- dokumentacioni i lëndimeve që mund të përdoren në gjykatë
- sigurimi i gjurmëve dhe provave

Mesazhet do të trajtohen në mënyrë konfidenciale. Punonjësit i nënshtrohen konfidencialitetit. Nëse është e nevojshme (p.sh. në rast të një seance gjyqësore të mëvonshme), raportet mjekoligjore mund të sigurohen në bazë të gjetjeve për të interpretuar lëndimet.

### **Klinika ambulatore për viktimat e dhunës në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Spitalin Universitar Münster (UKM)**

Tel.: 0251 / 83 5 51 60 web.ukm.de/index.php?id=rechtsmedizinergewaltopferambulan (Shënim: pa "z" në fund)

### **ASS (Mjekësia anonime ligjore)**

Si viktimë e një dhune seksuale, ju mund të merrni ndihmë mjekësore në klinikat e mëposhtme dhe të siguronit dhe të dokumentoni për gjurmët e krimit në mënyrë anonime dhe në mënyrë të aprovuar nga gjykata:

#### **Spitali Maria-Josef – Greven**

Urgjenca qendrore, Lindenstraße 29, 48268 Greven, Tel.: 02571 / 502-0

Nuk ka mjekësi ligjore në vend - udhëtim i shoqëruar falas në Spitalin Franziskus, Münster

#### **Klinika Rheine – Spitali Mathias Rheine**

Klinika e Grave, Frankenburgstraße 31, 48431 Rheine, Tel.: 05971 / 42-0

Mjekësia ligjore e mundur direkt në vend

#### **Klinika Ibbenbüren**

Große Straße 41, 49477 Ibbenbüren, Tel.: 05451 / 52-0

Nuk ka mjekësi ligjore në vend, udhëtim falas me ambulancën për në Spitalin Mathias, Rheine

## Çfarë ndihme është në dispozicion për fëmijët?

Shpesh fëmijët dhe të rinjtë preken gjithashtu nga dhuna në familje ose përjetojnë se si nëna e tyre abuzohet, poshtërohet ose frikësohet. Kjo mund të jetë traumatike për ta. Ata shpesh ndihen përgjegjës dhe/ose fajtor.

Fëmijët dhe të rinjtë që kanë qenë dëshmitarë të dhunës kanë nevojë për këshilla dhe mbështetje.

Kjo kërkon ndihmë profesionale përtej familjes. Fëmijët dhe të rinjtë marrin mbështetje dhe këshilla të veçanta ndër të tjera nga zyrat e mirëqenies së të rinjve në qarkun e Steinfurt dhe nga Shoqata Gjermane për Mbrojtjen e Fëmijëve në Rheine.

Fëmijët dhe të rinjtë mund të telefonojnë pa pagesë edhe në linjën telefonike të fëmijëve dhe të rinjve të Shoqatës Gjermane për Mbrojtjen e Fëmijëve në mbarë vendin nga telefonat fiks dhe celular.

**„Numri kundër pikëllimit“,**

**Telefon: 08 00 / 1 11 03 33 oder 116111**

Një person kontakti është në dispozicionin tuaj nga e hëna në të premte nga ora 14:00 deri në 20:00.

Numri i thirrur nuk shfaqet në faturën e detajuar për telefonata e kryera.

Është i mundur edhe këshillimi online ([www.nummergegenkummer.de](http://www.nummergegenkummer.de)).

**Klinika ambulatorie e Traumës për fëmijë dhe adoleshent në Klinikën për Mjekësi Pediatrike dhe Adoleshente në UKM**

Tel.: 0251/ 83-56440 (Sekretaria)

Tel.: 0251/ 83 56418 (Stacioni, i disponueshëm 24 orë në ditë)

E-Mail: [sekretariat-czerny@ukmuenster.de](mailto:sekretariat-czerny@ukmuenster.de)

[web.ukm.de/index.php?id=11725](http://web.ukm.de/index.php?id=11725)

## Çfarë ndihme është në dispozicion për djemtë dhe burrat?

Këshillim për krizat dhe dhunën - burrat këshillohen nga burrat

### Burrat e vërtetë flasin.

#### Burrat këshillohen nga burrat

Këshillimi për dhunën është një mundësi për djemtë dhe burrat që janë bërë të dhunshëm ose kanë frikë të bëhen të dhunshëm dhe duan të ndryshojnë sjelljen e tyre.

Qëllimi i konsultimit është të marrë përsipër përgjegjësinë e plotë për krimin e kryer - për veprimet e veta. Vetëm në këtë mënyrë meshkujt mësojnë se për sa vuajtje, frikë dhe lëndim janë përgjegjës. Ky pranim, që është i frikshëm dhe i turpshëm për shumicën e meshkujve, është baza më e rëndësishme për të thyer ciklin.

Shoqata Caritas Tecklenburger Land e. V.  
Klosterstr. 19

49477 Ibbenbüren

**Markus Temmen**

Tel.: 0171 3010652

Email: [gewaltberatung@caritas-ibbenbueren.de](mailto:gewaltberatung@caritas-ibbenbueren.de)

[www.echte-maenner-reden.de](http://www.echte-maenner-reden.de)

### Puna e autorit Chance e.V.

Chance e.V. ofron këshilla për autorët e dhunshëm në qarkun e Steinfurt. Së bashku, përpunohen shkaqet e sjelljes së dhunshme dhe alternativat ndaj saj. Një jetë pa dhunë dhe trajtimi jo i dhunshëm i situatave të konfliktit dhe krizës është qëllimi i këshillimit. Ofrohet këshillim individual dhe në grup. Konsultimi zhvillohet në rrugën Steinstr. 13 në Steinfurt-Burgsteinfurt.

#### Lothar Bardenhorst

Tel.: 0251 620 88 25

Mobil: 01515 5985193

Fax: 0251 620 88 49

[l.bardenhorst@chance-muenster.de](mailto:l.bardenhorst@chance-muenster.de)

#### Peter Runtenberg

Tel.: 0251 620 88 26,

Mobil: 01525 108 26 41

Fax: 0251 620 88 49

[p.runtenberg@chance-muenster.de](mailto:p.runtenberg@chance-muenster.de)

[www.chance-muenster.de/](http://www.chance-muenster.de/)

[taeterarbeit.html](http://taeterarbeit.html)

### Lidhje të mëtejshme për qendrat e ndihmës dhe këshillimit:

[www.maennerhilfetelefon.de/](http://www.maennerhilfetelefon.de/)

[www.maennerberatungsnetz.de/beratung/](http://www.maennerberatungsnetz.de/beratung/)

[www.maennergewaltschutz.de/maennerschutz-und-beratung/maennerschutzeinrichtungen/](http://www.maennergewaltschutz.de/maennerschutz-und-beratung/maennerschutzeinrichtungen/)

## Siguria ka prioritet - çfarë të bëni?

Në shenjë e parë të dhunës në familje, duhet të mendoni për sigurinë tuaj dhe të merrni masa paraprake për të mbrojtur veten dhe fëmijët tuaj. Ju mund të kërkonti strehim dhe të largoheni me fëmijët tuaj, edhe nëse dhunuesi ka kujdestarinë ose statusi juaj i lejes së qëndrimit varet nga bashkëjetesa me dhunuesin.

Bëni gjithçka që rrit ndjenjën tuaj personale të sigurisë.

- **Mos e lejoni veten të izoheni**, mbani kontakte me fqinjët tuaj dhe kërkonti nga miqtë dhe të afërmit që t'ju vizitojnë rregullisht!
- **Besojini mjekut tuaj të familjes** dhe certifikojini lëndimet tuaja!
- **Kontakttoni klinikën ambulatorë për viktimat e dhunës** dhe dokumentoni lëndimet tuaja në gjykatë!
- **Ruani numrin e urgjencës 110 për policinë** dhe numrat e personave që ju besoni në telefonin dhe/ose në celularin tuaj!
- **Largohuni nga shtëpia me fëmijët tuaj** nëse keni frikë nga aktet e dhunës ose ndiheni të kërcënuar!
- **Bëni kopje të dokumenteve që janë të rëndësishme për ju** (shih gjithashtu listën e kontrollit në faqen tjetër) dhe ia lini kopjet dikujt tek i cili keni besim!
- **Kontakttoni një qendër këshillimi** ku do të merrni këshilla, ndihmë dhe mbështetje

## Zhvendosja nga banesa - çfarë nevojitet?

Nëse largoheni nga banesa e përbashkët, ndër të tjera ju duhet të merrni me vete dokumentet dhe sendet e mëposhtme; dokumentet tuaja personale origjinale, dokumentet e përbashkëta si kopje.

### Lista e kontrollit:

- ✓ Çelësat (p.sh. për apartamentin, makinën, punë, dollapë, ...)
- ✓ Para kesh (në dorë), dokumente llogarie, kartë debiti, llogari kursimi, ...
- ✓ Kartë identiteti personale dhe kartë identiteti për fëmijët
- ✓ Kartat e sigurimit shëndetësor
- ✓ Certifikatat e martesës dhe lindjes
- ✓ Marrëveshjen e qerasë, kontratën e sigurimit
- ✓ Kontratë pune, vërtetime, kartë tatimi mbi të ardhurat, kartë e sigurimeve shoqërore
- ✓ Vendimet nga zyra e punës, zyra e mirëqenies sociale, zyra e mirëqenies së të rinjve, autoritetet e imigracionit,...
- ✓ Vendimet gjyqësore, p.sh. për urdhrat e mbrojtjes
- ✓ "Dokumentacioni për ndërhyrjen e policisë në dhunën në familje" (nëse disponohet tashmë nga incidentet e mëparshme)
- ✓ Medikamentet e nevojshme, certifikata mjekësore
- ✓ Artikuj të përdorimit personal
- ✓ Pajisje shkollore dhe lodra për fëmijët
- ✓ Veshje për ju dhe fëmijët tuaj
- ✓ Dokumentimi i shkatërrimit dhe/ose lëndimeve me telefon celular

## Çfarë ndihme financiare ekziston?

Nëse jeni ndarë nga dhunuesi pas një rasti të dhunës në familje, kjo mund të nënkuptojë se jeni përkohësisht e varur nga mbështetja financiare e shtetit. Kjo përfshin, për shembull, përfitimet sipas Kodit të Sigurimeve Shoqërore II, përfitimet sipas Ligjit të avancuar të mirëmbajtjes (UVG) dhe shërbimet sipas Ligjit për Kompensimin e Viktimave nga Aktet e Dhunshme (OEG).

### Përfitimet sipas Kodit Gjerman të Sigurimeve Shoqërore II

Nëse nuk mund të mbulonit "shpenzimet e domosdoshme të jetesës" për veten dhe fëmijët tuaj nga të ardhurat tuaja, asetet ose me ndihmën e të tjerëve, ju keni të drejtën për përfitimin e asistencës së papunësisë II/ndihma sociale.

Termi "shpenzimet e domosdoshme të jetesës" përfshin nevojat për ushqim, veshmbathje dhe strehim. Përveç kësaj, në kushte të caktuara, mund të aplikohen grante të njëhershme, p.sh. për mallra shtëpiake dhe sende të tjera të përditshme.

Sapo të vini re për një emergjencë financiare, p.sh. për shkak të humbjes së të ardhurave, duhet të aplikoni menjëherë personalisht në qendrën e punës në vendbanimin tuaj.

Kjo kërkon dëshmi të të ardhurave tuaja dhe rrethanave financiare me anë të dokumenteve të duhura (shih listën e kontrollit). Ju mund të informoheni nga qendra juaj e punës se cilat dokumente të tjera kërkojnë.

Nëse plotësohen kërkesat, përfitimi i papunësisë II / ndihma sociale mund të jepet nga muaji në të cilin është dorëzuar aplikimi.

### Përfitimet sipas Ligjit të avancuar të mirëmbajtjes (UVG)

Nëse dhunuesi nuk i përmbush detyrimet e tij për ushqim ndaj fëmijëve që jetojnë me ju, ju mund të aplikoni për përfitime sipas UVG-së për fëmijët tuaj.

Të gjithë fëmijët deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç që jetojnë me një prind të vetëm kanë të drejtë për përfitime UVG.

Ju mund ta paraqisni aplikimin në zyrën përgjegjëse të mirëqenies së të rinjve.

## Shërbimet sipas Ligjit për Kompensimin e Viktimave nga Aktet e Dhunshme (OEG)

Nëse dhunuesi ju ka shkaktuar dëmtim të shëndetit tuaj nëpërmjet një akti dhune (sulm fizik i qëllimshëm, i paligjshëm), ju përgjithësisht keni të drejtë për përkujdesje sipas OEG-së.

Këtë të drejtë e kanë edhe personat që kanë pësuar dëmtim të shëndetit të tyre gjatë mbrojtjes së ligjshme kundër një sulmi të qëllimshëm kundër jush.

Mund të jenë, për shembull, fëmijët tuaj, të njohurit ose fqinjët tuaj që donin t'ju ndihmonin ose që ju ndihmuan.

Ju mund të aplikoni për këtë në Shoqatën Rajonale të Westfalen-Lippe (Zyra e Mirëqenies së Westphalisë), Von-Vincke-Str. 23-25, 48143 Münster.

Ndër të tjera, me aplikimin do t'ju ndihmojnë kompania juaj e sigurimit shëndetësor, oficeri i policisë për mbrojtjen e viktimave ose punonjësit e "Unazës së Bardhë".

# Adresa dhe numra telefoni

## (sipas rendit alfabetik)

### Gjykata e Qarkut Ibbenbüren

Telefon: 0 5451 / 92 60  
 Fax: 0 5451 / 92 61 00  
 përgjegjëse për qytetet dhe komunat  
 Hörstel, Hopsten, Ibbenbüren, Mettingen, Recke,  
 Saerbeck

### Gjykata e Qarkut Rheine

Telefon: 0 59 71 / 4 00 50  
 Fax: 0 59 71 / 40 05 20  
 përgjegjëse për qytetet dhe komunat  
 Emsdetten, Neuenkirchen, Rheine

### Gjykata e Qarkut Steinfurt

Telefon: 0 25 51 / 6 60  
 Fax: 0 25 51 / 6 61 55  
 përgjegjëse për qytetet dhe komunat  
 Altenberge, Greven, Horstmar, Laer, Metelen,  
 Nordwalde, Ochtrup, Steinfurt, Wettringen

### Gjykata e Qarkut Tecklenburg

Telefon: 0 54 82 / 6 70  
 Fax: 0 54 82 / 67 12  
 përgjegjëse për qytetet dhe komunat  
 Ladbergen, Lengerich, Lienen, Lotte, Tecklenburg, Westerkappeln

### Zyra për çështjet sociale, shëndetësinë dhe kujdesin e qar- kut të Steinfurt, shërbimi social psikiatrik

Zyra Steinfurt  
 Telefon: 0 2551 / 69 28 30  
 Zyra Tecklenburg  
 Telefon: 0 2551 / 69 35 60  
 0 2551 / 69 35 70

Zyra Rheine  
 Telefon: 0 2551 / 69 40 27  
 0 2551 / 69 40 25

### Mjekësia anonime mjekoligjore ASS

Spitali Universitar Münster  
 Instituti i Mjekësisë Ligjore  
 Röntgenstr. 23  
 48149 Münster  
 Telefon: 0 251 / 835 51 51

Spitali Maria-Josef Greven  
 Urgjenca qendrore  
 Lindenstr. 29  
 48268 Greven  
 Telefon: 02571 / 50 20

Klinika Rheine, Spitali Mathias Rheine  
 Klinika e grave  
 Frankenburgstr. 31  
 48431 Rheine  
 Telefon: 05971 / 420

Klinika Ibbenbüren  
 Große Str. 41  
 49477 Ibbenbüren  
 Telefon: 05451 / 520

### Klinika mjekësore ambulatorë për mbrojtjen e fëmijëve e Kryqit të Kuq Gjerman

Melchersstr. 55  
 48149 Münster  
 Telefon: 0251 / 41 85 40  
 Fax: 0251 / 41 85 426

### Shërbime këshillimi për djem dhe burra nga shoqata Caritas Tecklenburger Land e. V.

Klosterstr. 19  
 49477 Ibbenbüren  
 Telefon: 0171 / 301 06 52

### Qendra këshillimore për prindër, të rinj dhe fëmijë e Sho- qatës Caritas

Bachstr. 15  
 48282 Emsdetten  
 Telefon: 0 25 72 / 157 39  
 Kirchstr. 5  
 48268 Greven  
 Telefon: 0 25 72 / 157 39  
 Klosterstr. 19  
 49477 Ibbenbüren  
 Telefon: 0 54 51 / 50 02 23  
 Lingener Str. 13  
 48429 Rheine  
 Telefon: 0 59 71 / 86 20



**Qendra këshillimore për prindërit, fëmijët dhe të rinjtë e  
Diakonischen Werks**

Stettiner Str. 25  
49525 **Lengerich**  
Telefon: 0 54 81 / 305 42 40  
Fax: 0 54 81 / 305 42 41

Wasserstr. 32  
48565 **Steinfurt**  
Telefon: 0 25 51 / 8637-0  
Fax: 0 25 51 / 8637-111

**Këshilla për ndarjen dhe divorcin**

**Për qytetet dhe komunat Ladbergen, Saerbeck, Hörstel,  
Hopsten, Recke dhe Mettingen:**

Kreisel e.V.  
Schulstr. 11a, 49477 Ibbenbüren,  
Telefon: 02572 / 882 60

**Për qytetet dhe komunat Westerkappeln, Lotte, Tecklen-  
burg, Lengerich dhe Lienen:**

Qendra e Këshillimit Diakonie  
Stettiner Str. 25, 49525 Lengerich  
Telefon: 05481 / 305 42 66

**Për qytetet dhe komunat Altenberge, Nordwalde dhe  
Steinfurt-Borghorst:**

Shoqata Caritas Steinfurt  
Kirchplatz 8, 48565 Steinfurt  
Telefon: 02552 / 702 4914

**Për qytetet dhe komunat OchtrupStein- furt-Burgstein-  
furt, Metelen, Horstmar dhe Laer:**

Shoqata Caritas Steinfurt  
Kirchplatz 8, 48565 Steinfurt  
Telefon: 02552 / 702 4914

**Për qytetet dhe komunat Wettringen dhe Neuenkirchen  
dhe Rheine:**

Shoqata Caritas Rheine  
Lingener Str. 11, 48429 Rheine  
Telefon: 05971 / 8 62 13 15

**Për qytetin Emsdetten:**  
Shoqata Caritas Emsdetten-Greven  
Bachstr. 15, 48282 Emsdetten  
Telefon: 02572 / 157-0

Kreisel e.V.  
Friedrichstr. 1-2, 48282 Emsdetten  
Telefon: 02572 / 882 60

**Për qytetin Greven:**  
Shoqata Caritas Emsdetten-Greven  
Kirchstr. 5, 48268 Greven  
Telefon: 02571 / 800 90

**Për qytetin Ibbenbüren:**  
Shoqata Caritas Ibbenbüren  
Klosterstr. 19, 49477 Ibbenbüren  
Telefon: 0 54 51 / 500 20

**Shoqata Gjermane për Mbrojtjen e Fëmijëve**

An der Stadtmauer 9, 48431 Rheine  
Telefon: 0 59 71 / 91 43 90  
Fax: 0 59 71 / 91 439 33

**Qendra e këshillimit për martesën, familjen dhe jetën në  
dioqezën e Münster**

48282 Emsdetten  
Kirchstr. 18  
Telefon: 02572 / 9419019

48268 Greven  
Münsterstr. 35  
Telefon: 02571 / 98 65 81

49477 Ibbenbüren  
Klosterstr. 19  
Telefon: 0 54 51 / 5002 53

48565 Steinfurt  
Europaring 1  
Telefon: 0 25 51 / 86 44 46

48429 Rheine  
Herrensreiberstr. 17  
Telefon: 0 59 71 / 9 68 90

**Qendra e këshillimit të grave me qendër të integruar këshilluese të specializuar kundër dhunës seksuale e Diakonie West e.V.**

Qendra e këshillimit të grave  
Münstermauer 3  
48431 Rheine  
Telefon: 0 59 71 / 800 73 70  
frauenberatungsstelle@diakonie-west.de

Qendra e këshillimit kundër dhunës seksuale  
Münsterstr. 48  
48431 Rheine  
Telefon: 05971 / 800 92 92  
fachberatung-gewalt@diakonie-west.de

**Streha e grave në Rheine**

Telefon: 05971 / 1 27 93  
(mund të telefononi 24 orë në ditë,  
takime konsultimi sipas dakordësimit telefonik)

**Klinika ambulatorie e viktimave të dhunës**

UKM – Spitali Universitar Münster,  
Röntgenstraße 23, 48149 Münster  
Telefon: 0251 / 83 5 51 51

**Telefoni i ndihmës „Dhuna kundër grave“**

Telefon: 08000 116 016 dhe online në  
[www.hilfetelefon.de](http://www.hilfetelefon.de)

**Telefoni i ndihmës „Dhuna tek burrat“**

Telefon: 0800 1 239 900 dhe online në  
[www.maennerhilfetelefon.de](http://www.maennerhilfetelefon.de)

**Qendra e punës**

Ju lutemi kontaktoni qendrën e punës në administratën e qytetit ose  
komunës së vendbanimit tuaj

**Zyra e Mirëqenies së të rinjve e qytetit Emsdetten**

Am Markt 1  
48282 Emsdetten  
Telefon: 02572 / 92 23 16

**Zyra e Mirëqenies së të rinjve e qytetit Greven**

Rathausstr. 21  
48268 Greven  
Telefon: 02571 / 92 00

**Zyra e Mirëqenies së të rinjve e qytetit Ibbenbüren**

Alte Münsterstr. 16  
49477 Ibbenbüren  
Telefon: 05451 / 93 15 29  
05451 / 93 16 25

**Zyra e Mirëqenies së të rinjve e qytetit Rheine**

Klosterstr. 14  
48431 Rheine  
Telefon: 05971 / 93 95 11

**Zyra e Mirëqenies së të rinjve e qarkut Steinfurt**

Tecklenburger Str. 10  
48565 Steinfurt  
Telefon: 02551 / 69 23 05

**Zyra e Mirëqenies së të rinjve e qarkut Steinfurt**

Zyra Tecklenburg  
Landrat-Schultz-Str. 1  
49545 Tecklenburg  
Telefon: 02551 / 69 32 22

**Numri kundër pikëllimit**

Numër telefoni për fëmijë dhe të rinj  
Telefon: 116 111  
Elterntelefon  
Telefon: 0800 / 11 105 50

**Oficeri i mbrojtjes së viktimave i autoritetit policor të qarkut Steinfurt**

Hansaallee 10  
48429 Rheine  
Telefon: 05971 / 9 38 59 14  
05971 / 9 38 59 17



Ndihmë e disponueshme 24 orë në ditë



Numri i urgjencës  
**policore 110**

Streha e grave në Rheine  
**059 71 / 1 27 93**

Telefoni i ndihmës  
**"Dhuna kundër grave"**  
**08000 – 116 016**  
**[www.hilfetelefon.de](http://www.hilfetelefon.de)**